

VENDIM
Nr. 147, datë 22.2.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E PUNËVE TË
BRENDSHME TE KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, TË DEPOS NR.3 DHE
KAPANONET NR.1, PJESË PËRBËRËSE TË PRONËS ME EMËRTIMIN “AGJENCIA
LUNDËR”, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.413, DATË 11.7.2007, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
REZERVAVE TË SHTETIT)”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 12, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Punëve të Brendshme te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të Depos nr.3 dhe Kapanonet nr.1, pjesë përbërëse të pronës me emërtimin “Agjencia Lundër”, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim ruajtjen dhe magazinimin e bazës logjistike zgjedhore.


2. Pronat e përmendura në pikën 1, hiqen nga lista që i bashkëlidhet vendimit nr.413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe përmasat e tyre ndryshojnë dhe zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në genplanin dhe planimetritë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe përbëhen, gjithsej, nga 3 (tre) fletë.

3. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetërsojë ato ose t’ua japë në përdorim të tretëve.


4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit, kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



PLANIMETRIA E DEPOS NR. 3, LUNDER



PLANIMETRIA E KAPANONIT, LUNDER

